

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, nga gjyqtari Bekri Vehapi, në procedurën kundërvajtjese kundër të pandehurit Tafil Krasniqi nga fshati Brezne komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17.par,1,3 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar. e në bazë të nenit 73 dhe 195 par.1 të Ligjit mbi kundërvajtjet /"Gazeta zyrtare e Kosovës", nr.23/79/ me datën 08.08.2012, merrë këtë

AKTVENDIM

PEZULLOHËT procedura kundërvajtjese kundër të pandehurit Tafil Krasniqit në fshatin Brezne komuna e Dragashit, Shqiptar,Shtetas i Republikës së Kosovës, me vendbanim të përherëshëm në vendlindje.

Konform nenit 198 par.1 pika 8 të LMK-ës, si në arsyetim.

Arsyetim

Me kërkesën e Agjencionit të Kosovës kundër korupcionit në Prishtinë, nr.01-2149/2012 të datës 04.06.2012, Gjyqtari me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtjese kundër të pandehurit Tafil Krasniqi,me të dhënat si në diapozitiv.

Gjykata gjat shqyrtimit të shkresavë të lëndes të agjencionit e konkretisht në bazë të vërtetimit të këtij agjencioni nr. 03-2228/2012 i datës 30.03.2012, pa dyshim është konstatuar dhe vërtetuar se i pandehuri Tafil Krasniqi zyrtar-Drejtor i shërbimeve publike me datën 30.03.2012 e ka bërë deklarimin e pasurisë dhe njëherit e ka përmbushur obligimin ligjor në afatin e caktuar sipas Ligjit me nr. 04/L-050.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, Me datën 08.08.2012, Re.I.nr.638/2012.

Gjyqtari për kundërvajtje,
Bekri Vehapi

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me 2.egzenplar pa taksë përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS	
AGJENCIA KUNDËR KORUPSIONIT / AGENCIA PËR TËRREKTET / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK / DMP	Nr. Prot. 03-2951/12
Dep. DPK / DMP	Br Prot. 03-2951/12
Nr. Prot. 01	Data 22.08.2012
Br Prot. 01	Data 22.08.2012
PRISHTINE	